



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 273, Datë 13.12.2024

MBI

MIRATIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U  
PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 10 dhe 31 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2532prot., datë 12.12.2024 të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme “Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025”,

**Konstatoi se:**

- Në mbështetje të nenit 10 të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW. Në pikën 4 të këtij neni përcaktohet se: “Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW caktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit”. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE-ja në vitin 2016”.
- Gjithashtu në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji përcaktohet se aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (Ligjit 24/2023).

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, i ndryshuar, është miratuar metodologjia e përcaktimit të “Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi ku ky çmim përllogaritet sipas formulës si vijon:  
*çmimi vjetori i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normënmesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.*
- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 11 mujore të tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2024, i cili rezulton në vlerën 96.76 Euro/MWh.
- Sipas metodologjisë, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2024. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, kursi mesatar i këmbimit për periudhën 11-mujore të vitit 2024 rezulton të jetë 101.13 Lekë/euro
- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike referuar tregut të ditës në avancë të Bursës Hungareze të Energjisë HUPX do të jetë 11.74 Lekë/kWh. Në zbatim të VKM nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, e ndryshuar, ky çmim rezulton të jetë mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në gërmën “d”, prej 10 lekë/kWh.
- Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 24/2023, i cili parashikon se kriteret e llogaritjes së çmimit, do të bazohen në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, edhe pse në kushtet e mungesës së një metodologjie e cila i referohet llogaritjes së këtij çmimi, duke u bazuar në tregun shqiptar të organizuar të energjisë elektrike, ku çmimi mesatar klerues i bursës shqiptare të energjisë ALPEX, për periudhën 11-mujore të vitit 2024, rezulton të jetë në vlerën prej 108.3 Euro/MWh, rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike referuar tregut të ditës në avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX, do të rezultonte në vlerën 13.14 Lekë/kWh, përsëri mbi nivelin maksimal prej 10 lekë/kWh, të përcaktuar në metodologjinë në fuqi.
- Për rrjedhojë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024 do të jetë ai prej 10 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2025.

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**